



VENDIMI ëSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / UROŠEVAC

Më  
Dana

27.04.2018

P.nr.3085/2017

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Adem Shabani, më pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Blend Rexhepi, procesimbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarëve [REDACTED], nga [REDACTED] Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.I nën par.I.4 të KPRK-së, dhe [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, përshka të veprës penale kanosje nga neni 185 par.I të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP.II.nr.2510-5/2015 të datës 05.12.2017, pas mbajtjes së seancës fillestare në pranin e Prokurorit të Shtetit Mimoza Syla, të akuzuarëve [REDACTED] dhe [REDACTED] me datë 23.03.2018, publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. [REDACTED], nga [REDACTED] Republika e Shqipërisë, me vendbanim në Ferizaj, në rrugën "Halil Alidema", i lindu me datë [REDACTED], në [REDACTED] Republika e Shqipërisë nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] mbiemri i vajzërisë [REDACTED], me arsimim fillorre, i gjendjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri.

2. [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, e lindur më [REDACTED], [REDACTED], shtetase e republikës së Kosovës, nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] mbiemri i vajzërisë [REDACTED], ka të kryr shkollen filllore,e martuar nënë e katër fëmive e gjendjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri.

### J A N Ë F A J T O R

I akuzuai - [REDACTED]

Me datë 18 Dhjetor 2015 rrëth orës 01:00 në rrugën "Halil Alidema", në Ferizaj, i pandehuri e lëndon të dëmtuarin [REDACTED] në atë mënyrë që pas një fjalosje të ndodhur aty, e godet të njëjtin me grushta dhe shqelma duke i shkaktuar lëndime trupore, e që bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor të datës 17 Maj 2017, lëndimet e tillë bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore dhe me pasoja të përkohshme për shëndtin,-

- Me të ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.I nën par.I të KPRK-së.

E akuzuara [REDACTED]

## ËSHTË FAJTORE

Sepse me 18 Dhjetor 2015, rreth orës 21:00, në Ferizaj, e ka kanosur të dëmturen [REDACTED] në atë mënyrë që përmes një mesazhi e kanos m fjalët "kesh te banesa, nuk kishte qenë aty se ju kisha mbyt krejtëve", me ç'rast kjo kanosje ka shkatuar shqetësim dhe frikë tek e dëmtuara,-

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, 49, 50, 51, 52 dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarit i

### G J Y K O N

I.Të akuzuarit [REDACTED], për vepren penale që akuzohet për pikën e parë të dispozitivit të aktakuzës i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 200 /dyqindë/ €uro, të cilin dënim me gjobë, nga rrethanat e arsyeshme i mundëson ta paguan me këste për një priudhë prej katër muajëve, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjtë dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 €uro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedures penale për ekspertizën mjekoligjore shumën prej 20 €uro, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) €uro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm

Obligohet i akuzuari të paguaj taksën në shumën prej 30 €uro, konform nenit 39 paragrafi 3 nënpagragafi 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimtit.

I dëmtuari [REDACTED] nga Prishtina, rruga e [REDACTED], për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike udhëzohen në kontest civil.

II.Të akuzuarës [REDACTED] për vepren penale për pikën dy të dispozitivit të aktakuzës i shqipton shqiptohet dënimin me kusht me burg prej 3 (tre) muajve, të cilat dëname nuk do të ekzekutohen nëse e akuzuara në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Të dëmtuarën [REDACTED] nga ferizaj, rruga [REDACTED], për realizmin e kërkesë pasuroro-juridike është udhëzuar në në kontest civil.

Obligohet ei akuzuarit tē paguaj shpenzimet e procedures penale- paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) €uro, dhe taksën në shumën prej 30 €uro, konform nenit 39 paragrafi 3 nënparagraghi 3.1 tē Ligjit pér Kompenzimin e Viktimate të Krimtit, tē gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërenim tē përmbarimit tē dhunshëm.

#### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtuar aktakuzë nën numrin PP.II.nr.2510-5/2015 tē datës 05.12.2015, kundër tē akuzuarëve [REDACTED] nga [REDACTED] Republika e Shqipërisë, pér veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 tē KPRK-së, dhe [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, pér veprën penale kanosje nga neni 185 par.1 tē KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rrëth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 tē KPPRK-së me dt.23.03.2018, ka mbajtur shqyrtimin filletar në tē cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit, tē akuzuarit.

Në fillim tē shqyrtimit filletar tē akuzuarit janë udhëzuar në kuptim tē nenit 246.1 tē KPPRK-së pastaj gjyqtari gjykuar ka çmuar se tē drerjat e tē akuzuarëve janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën tē akuzuarëve dhe pasi që gjyqtari është bindur se tē njëjtë e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën me tē cilën janë akuzuar, tē njëjtëve i ka dhënë mundësi tē deklarohen mbi fajësinë apo palajësinë e tyre lidhur me veprat penale pér tē cilat akuzohen.

I akuzuarit [REDACTED], ka pranuar fajësinë pér veprën penale që akuzohet ku pér këtë ka deklaruar dhe më parës në polici dhe është e vërtetë se pas një fjalosje tē ndodhur aty, e godet me një shuplak tē dëmtuarin [REDACTED] pasi aty kishte shkuar qëta merrë bashkëshorten e ku me shoqen e saj [REDACTED] kishte shkuar aty pa e pytur këtë, i inatosur nuk ka munë ta kontrollon veten dhe e ka kryer këtë vepër penale i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit tē denimit tē merrë pér bazë thekësimet e cekura si rrëthana lehtësuese me rastin e shqiptimit tē denimit.

E akuzuara [REDACTED] në shqyrtimin filletar ka pranuar fajësinë pér veprën penale që akuzohet dhe në vazhdim ka deklaruar se është e vërtetë se e ka kanosur tē dëmturën [REDACTED] me një mesazh përmes telefonit tē djalit tē saj, e qëllimi i kanosjes ishte që ta frikëson por më nuk i'u është kanosur e tanë nuk e di se ku gjindet, ka premuar se më ate nuk do ta kanosur pasi nuk ka kurfar problemi me te, i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit tē denimit tē merrë pér bazë thekësimet e cekura më lartë pasi gjendjen ekonomike nuk e ka tē mire është nën e katër fëmijëve ku tē vetmin burim tē tē ardhurave e ka ajo që merrë nga puna.

Pas pranimit tē fajësisë nga ana e tē akuzuarit gjyqtari në kuptim tē nenit 248 par.2 tē KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit tē shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurorja e shtetit Mimoza Syla, në shqyrtimin filletar ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tē akuzuarëve pasi tē akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit tē fajësisë, pranimin e kanë bër vullnetarishtë dhe e kanë mbështetur në faktet e çështjes që përban akusa.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e kanë bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dh atë në deklaratat e dhëna në polici dhe në shqyrtimin filletar dhe vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit [REDACTED] manifestohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, kurëse te e akuzuara [REDACTED] manifestohen të gjitha elementet e veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarëve vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga të akuzuarëve, pendimin për veprat penale që i kanë kryer, sjellja e tyre korekte gjatë gjykimit, rrethanat familjare të akuzuarëve, gjer më tanë nuk ka qenë të gjykuar, dhe nga koha kur i kanë kryer këto vepra penale ka kaluar një kohë gjatë dhe se me të dëmtuarit më nuk kanë patur mosmarrëveshtje, bazuar në këto rrethana gjykata i shqiptoi dënimet veç e veç të akuzuarëve për veprat penale që akuzohen si në dispozitiv të aktgjykitin, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarëve dhe me të arrihet qëllimi ndëshkimore në kuptim të preventivës speciale që të akuzuarit të mos kryejë vepra penale në të ardmën si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj veprë penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par.3 të KPPK-së të dëmtuarit [REDACTED] nga Prishtina, rruga e [REDACTED], dhe [REDACTED] nga Ferizaj, rruga [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me ninen 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompenzin e viktimate të krimtit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,  
P.nr.3085/17 me datë 23.03.2018

Zyrtari Ligjor  
Blend Rexhepi

Gjyqtari  
Adem Shabani  


**KËSHILLA JURIDIKE:**Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.